2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike..

Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon vendimin përfundimtar për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti/ Enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;
 - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.
3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.
4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 2: Formulari i Ofertës ekonomike, për procedurat e prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët nga operatori ekonomik

Shtojca 3: Listat e Çmimeve të artikujve

Shtojca 4: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 5: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Sasisë dhe Grafikut i lëvrimit

Shtojca 8: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 9: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 10: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimimit

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁴

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontratës;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

⁴ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

[Në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët, nga operatori ekonomik plotësohet dhe paraqitet vetëm kjo Shtojcë]

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

ç) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute është si më poshtë:

1	2	3
Nr.	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit e shprehur ne vlerë absolute

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Kujdes: Bazuar në parashikimet e nenit 45/2.1 të VKM Nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, kur si kriter vlerësimi përdoret “oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët”, autoriteti/enti kontraktor përllogarit çmimin bazuar në:

- a) *çmimin e bursës, së datës kur është publikuar njoftimi i kontratës së procedurës së prokurimit, i konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të kësaj date*
- b) *elementet fiskale;*
- c) *normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës;*

Shtojca 3.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në këtë Formular duhet të plotësohen dhe t'u vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa vlerë do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

1	2	3	4	5	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi per njesi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Date _____	

Shënim:

\

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së.*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e *[emri i autoritetit/entit kontraktor]* vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në *[njoftimin e kontratës]*.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 5.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

SPECIFIKIMET TEKNIKE PËR LOTIN E 1 ME OBJEKT: "BLERJE KABINET KUZHINE"

Nr.	Përshkrimi teknik	Specifikime teknike minimale	Njësia
❖ 1	Element neutral inox 2 kate me kabinet të hapur dhe sirtar, gjerësi 700 mm, sipërfaqe 50% e lëmuar / 50% me brazda	Element neutral profesional inox AISI 304, strukturë me 2 kate, kabinet i hapur dhe sirtar, gjerësi 700 mm, sipërfaqe pune higjienike rezistente ndaj nxehtësisë dhe korrozionit.	copë
❖ 2	Pianurë elektrike me 4 vatra, me funksion konveksioni	Pianurë elektrike profesionale me 4 zona gatimi, fuqi e lartë, kontroll temperaturash i pavarur, funksion konveksioni, 220–400V sipas modelit.	copë
❖ 3	Grilë elektrike me bazë kabinetit, sipërfaqe 50% e lëmuar / 50% me brazda	Grilë profesionale elektrike inox, sipërfaqe kombinim e lëmuar dhe e brazduar, me kabinet bazë dhe kontroll temperature të rregullueshëm.	copë
4	Fritezë elektrike me 2 depozita (8+8 L), fuqi 2.8 + 2.8 kW, monofazë	Fritezë profesionale inox me dy kazanë 8+8 L, termostad i pavarur për çdo depozitë, 220–240V monofazë, sistem sigurie termike.	copë

5	Banko pune inox 2 kate, dimensione 2000 × 900 mm	Banko pune profesionale inox AISI 304, 2 nivele, strukturë e përforcuar, dimensione 2000×900 mm, rezistente ndaj lagështisë dhe nxehtësisë.	copë
❖ 6	Furrë kombi elektrike, kontroll digjital, 3-fazore, kapacitet 6×GN 1/1, me aspirim dhe 4 tava modulare	Furrë kombi profesionale 3-fazore, kontroll digjital, kapacitet 6 GN 1/1, sistem avulli dhe ventilimi, me aspirim dhe aksesore modulare.	copë
❖ 7	Banko inox për furrë	Bazament profesional inox për furrë, strukturë e përforcuar, rezistent ndaj temperaturës dhe peshës së lartë.	copë
8	Rafte inox nga toka 2m x 1.5m	Sistem rafte inox AISI 304, strukturë dyshe ose shumëkatëshe, rezistent ndaj ngarkesës dhe lagështisë, dimension 2m x 1.5m.	set
❖ 9	Lavaman me kabinet inox AISI 304, 2 basene, krah kullimi, backsplash 180×70×85 cm	Lavaman profesional inox AISI 304 me 2 gropa, krah kullimi, backsplash higjienik, strukturë me kabinet poshtë, dimension 180×70×85 cm.	copë
❖ 10	Lavastovilje profesionale tip ECO 50	Lavastovilje profesionale industriale ECO 50, cikël i shpejtë larjeje, konsum i ulët uji dhe energjie, 220–400V sipas modelit.	copë
❖ 11	Pompë detergjenti	Pompë dozimi detergjenti për lavastovilje profesionale, me rregullim automatik të dozës.	copë
❖ 12	Afetatrice (slicer) Ø250 mm	Makineri prerëse profesionale Ø250 mm, teh çeliku inox, sistem sigurie dhe rregullim trashësie prerjeje.	copë
❖ 13	Makinë për mish dhe djathë	Makineri profesionale për përpunim mishi dhe djathi, motor industrial, trup inox, prodhim i lartë orar.	copë
❖ 14	Furrë pice profesionale me bazament, 2 dhoma, kapacitet 4+4 pica Ø350 mm, kontroll mekanik, me aspirim	Furrë pice profesionale me 2 dhoma, kapacitet 4+4 pica Ø350 mm, kontroll mekanik temperature, sistem aspirimi dhe izolim termik.	copë
❖ 15	Brumatrice profesionale 50L 1500W 25/S	Brumatrice industriale 50 litra, motor 1500W, strukturë inox, 2 shpejtësi pune, për brumëra profesionalë.	copë
❖ 16	Mikser profesional 5 L	Mikser profesional kuzhine 5 litra, motor i fuqishëm, shpejtësi të rregullueshme, trup metalik.	copë
❖ 17	Makinë për hapjen e brumit me transportues 2400 mm	Makinë profesionale për hapje brumi me transportues, gjatësi 2400 mm, rregullim trashësie automatik.	copë
❖ 18	Lavaman inox 1–2 basene me rubinet profesional (për peshk)	Lavaman profesional inox AISI 304, 1–2 gropa, me rubinet industrial, rezistent ndaj ujit dhe korrozionit, për përdorim ushqimor.	copë

Shënime të përgjithshme për furnizimin

Të gjitha pajisjet duhet të jenë të prodhuara nga material **inox AISI 304** ose ekuivalent me cilësi të njëjtë ose më të lartë.

Pajisjet duhet të jenë **profesionale, të projektuara për përdorim intensiv dhe të vazhdueshëm në kushte pune industriale/kuzhine profesionale.**

Furnizuesi duhet të ofrojë **garanci minimale 12 (dymbëdhjetë) muaj** për të gjitha pajisjet, duke përfshirë defektet e prodhimit dhe funksionimit.

Në ofertë duhet të përfshihet detyruesisht **transporti, dorëzimi në objekt dhe instalimi i plotë i pajisjeve**, gati për përdorim.

Të gjitha pajisjet duhet të jenë të reja, të papërdorura dhe të shoqëruara me dokumentacion teknik dhe certifikata konformiteti (CE ose ekuivalente).

LISTA E MATERIALEVE PËR INFRASTRUKTURËN E KUZHINËS PROFESIONALE

Nr.	Përshkrimi teknik	Specifikime teknike minimale	Njësia
1	Dalje prizë tip Schuko (16A, 230V)	Prizë elektrike Schuko 16A, 230V, montim mural, me tokëzim të sigurt, trup PVC rezistent ndaj nxehtësisë dhe goditjeve, standard CE.	copë
2	Linjë elektrike 3-fazore (3P), kabllo 5×4 mm ²	Kabllo elektrike 3-fazore 5×4 mm ² (3 faza + neutër + tokë), izolim PVC/XLPE, rezistente ndaj temperaturës dhe ngarkesës industriale.	copë
3	Panel elektrik i jashtëm (deri në 34 module)	Panel elektrik i jashtëm IP54 ose më i lartë, kapacitet deri në 34 module, me shina DIN, derë transparente dhe mbrojtje kundër lagështisë dhe pluhurit.	copë
4	Linjë kryesore furnizimi, kabllo 4×16 mm ² + 1×10 mm ² (tokëzim)	Kabllo fuqie industriale 4×16 mm ² + 1×10 mm ² për tokëzim, izolim XLPE, për përdorim në ngarkesa të larta elektrike dhe instalime kryesore.	ml
5	Motor aspirimi profesional (ventilator industrial)	Ventilator industrial për aspirim, motor elektrik me efikasitet të lartë, kapacitet i lartë thithjeje, trup metalik anti-korroziv, punë e vazhdueshme.	copë
6	Kapë aspirimi inox (hood)	Kapë aspirimi inox AISI 304, me filtër yndyre të integruar, ndriçim të brendshëm dhe sistem kanalizimi për avuj dhe tymra kuzhine profesionale.	copë
7	Tub aspirimi Ø300 mm (kanal kryesor)	Tub ajrimi Ø300 mm, material galvanizuar ose inox, rezistent ndaj temperaturës dhe yndyrës, për sistem aspirimi industrial.	copë
8	Filtra për aspirim (metalike/yndyre)	Filtra metalikë për kapë aspirimi, të larshëm dhe rezistent ndaj yndyrës, efikasitet i lartë filtrimi.	copë
9	Ndriçues LED industrial	Ndriçues LED industrial, IP65, dritë e bardhë 4000–6000K, konsum i ulët energjie dhe jetëgjatësi e lartë.	copë
10	Tub aspirimi (segmentet lidhëse)	Tub lidhës për sistem aspirimi, material galvanizuar ose inox, për lidhje segmentesh të kanalit kryesor të ajrit.	ml

Sqarime teknike

Kabllot elektrike duhet të jenë **rezistente ndaj temperaturës së lartë, lagështirës dhe kushteve industriale të punës**, me izolim të tipit PVC/XLPE ose ekuivalent, të certifikuar sipas standardeve CE.

Sistemi i aspirimit duhet të jetë i projektuar dhe i instaluar në përputhje me **standardet për nxjerrjen e tymit, avujve dhe yndyrës në ambiente profesionale të kuzhinës**, duke garantuar eficiencë të lartë filtrimi dhe qarkullimi ajri.

Paneli elektrik duhet të jetë i kompletuar dhe i pajisur minimalisht me:

Automatikë mbrojtës (MCB) për çdo linjë furnizimi
Mbrojtje diferenciale (RCD) për siguri ndaj rrjedhjeve të rrymës
Mbrojtje nga mbingarkesa dhe qarku i shkurtër , e përshtatur për ngarkesat e instaluara
Të gjitha komponentët elektrikë dhe mekanikë duhet të jenë të certifikuar dhe të përshtatshëm për përdorim profesional të vazhdueshëm.

PAJISJE DHE MOBILIM PËR AMBIENTE SHËRBIMI / KUZHINE PROFESIONALE

Nr.	Përshkrimi teknik	Specifikime teknike minimale	Njësia
❖ 1	Raft inox mbi lavaman për kullimin e enëve	Raft profesional inox AISI 304 për montim mbi lavaman, strukturë rezistente ndaj lagështirës dhe korrozionit, me sistem kullimi për enët dhe pjata.	copë
❖ 2	Mobilje / raft magazinimi (200×150×60 cm)	Raft magazinimi metalik ose inox, dimensione 200×150×60 cm, strukturë e përforcuar për ngarkesë të lartë, rafte të rregullueshme.	copë
❖ 3	Tavolina pune / shërbimi	Tavolinë profesionale pune inox AISI 304 ose ekuivalent, sipërfaqe higjienike, rezistente ndaj nxehtësisë dhe korrozionit, konstruksion i fortë.	copë
4	Karrige	Karrige profesionale për ambient shërbimi, strukturë metalike ose plastike të përforcuar, rezistente ndaj përdorimit intensiv.	copë
❖ 5	Frigorifer profesional 2 dyer	Frigorifer profesional inox, 2 dyer, temperaturë pune 0/+10°C, kapacitet industrial, sistem ftohjeje ventiluar, dimensione rreth 142×70 cm.	copë
❖ 6	Frizer (ngrirës) profesional	Frizer profesional inox, temperaturë -18/-22°C, sistem ngrirjeje statike ose ventiluar, dimensione rreth 71×80×203 cm.	copë
❖ 7	Makinë kafeje profesionale espresso	Makinë espresso profesionale me 2 grupe, presion 9 bar, boiler ≥10 L, fuqi 3000–4000 W, trup inox, përdorim intensiv.	copë
❖ 8	Boiler (ngrohës uji)	Boiler elektrik profesional për ujë të ngrohtë, kapacitet mesatar, izolim termik, mbrojtje nga mbinxehja.	copë
❖ 9	Furrë mikrovalë	Furrë mikrovalë profesionale, fuqi e lartë, kontroll elektronik ose mekanik, për përdorim intensiv në ambiente shërbimi.	copë
10	Veshje muri plexiglas (imitim mermeri)	Panele plexiglas dekorative me efekt mermeri, rezistente ndaj lagështirës dhe nxehtësisë, montim mural, trashësi standard industrial.	m ²

LISTA E ENËVE DHE AKSESORËVE TË KUZHINËS PROFESIONALE

Nr.	Përshkrimi teknik	Specifikime teknike minimale	Njësia
1	Tigan alumini profesional Ø32 cm	Tigan profesional alumini me bazë të përforcuar, shpërndarje uniforme nxehtësie, dorezë ergonomike rezistente ndaj temperaturës së lartë.	copë
2	Tigan alumini profesional Ø24 cm	Tigan profesional alumini, rezistent ndaj konsumit, me veshje anti-ngjitëse dhe dorezë izoluese.	copë

3	Tenxhere e thellë (casserole) Ø24 cm	Tenxhere profesionale inox ose alumini i fortifikuar, kapak i mbyllur, rezistente ndaj temperaturave të larta.	copë
4	Tenxhere e thellë Ø28 cm	Tenxhere profesionale për përdorim intensiv, material inox/alumin i përforcuar, shpërndarje uniforme nxehtësie.	copë
5	Tenxhere e madhe Ø32 cm	Tenxhere industriale për gatim në sasi të mëdha, material inox, kapak metalik, rezistente ndaj deformimit.	copë
6	Tas (bowl) Ø15 cm	Tas profesional për kuzhinë, porcelan ose inox, rezistent ndaj goditjeve dhe temperaturës.	copë
7	Pjatë e sheshtë Ø29 cm	Pjatë porcelani profesionale, rezistente ndaj çarjes dhe përdorimit intensiv në restorant.	copë
8	Pjatë e sheshtë Ø20–21 cm	Pjatë porcelani standarde për shërbim ushqimi, sipërfaqe e lëmuar dhe rezistente ndaj larjes industriale.	copë
9	Pjatë e thellë (supë/pasta)	Pjatë porcelani e thellë për supa dhe pasta, rezistente ndaj temperaturës së lartë.	copë
10	Pjatë porcelani (16–24 cm)	Pjata porcelani profesionale në disa dimensione, e përshtatshme për servirje të ndryshme ushqimi.	copë
11	Pjatë ovale porcelani 33 cm	Pjatë ovale profesionale porcelani, për prezantim dhe servirje.	copë
12	Thikë shefi 24 cm	Thikë profesionale kuzhine inox, teh 24 cm, balancim ergonomik, për prerje intensive.	copë
13	Thikë buke (dhëmbëzuar) 32 cm	Thikë profesionale për bukë me teh të dhëmbëzuar, inox, dorezë ergonomike.	copë
14	Thikë mishi (e madhe + e vogël)	Set thikash për mish, inox profesional, teh i mprehur për prerje precize.	copë
15	Thikë universale	Thikë multifunksionale kuzhine inox, për përdorim të përgjithshëm.	copë
16	Thikë për midhje 15 cm	Thikë profesionale për hapje midhjesh, teh i fortë inox.	copë
17	Hanxhar profesional (cleaver)	Hanxhar profesional inox për prerje mishi dhe kockash, trup i përforcuar.	copë
18	Gërshërë kuzhine	Gërshërë profesionale inox, rezistente ndaj korrozionit dhe përdorimit intensiv.	copë
19	Çekiç për mish	Çekiç profesional për zbutje mishi, trup metalik me dorezë ergonomike.	copë
20	Dërrasa prerëse HDPE	Dërrasa prerëse profesionale HDPE, rezistente ndaj baktereve dhe prerjeve, ngjyra të ndryshme për higjienë.	copë
21	Spatul inox/plastik	Spatul profesional rezistent ndaj temperaturës së lartë, për përdorim në gatim.	copë
22	Lugë druri/bambu	Lugë kuzhine druri ose bambu, rezistente ndaj nxehtësisë dhe ushqimeve.	copë
23	Rrahëse vezësh (tel inox)	Rrahëse profesionale inox për përzierje dhe rrahje ushqimesh.	copë
24	Garuzhde inox	Garuzhde profesionale inox, madhësi të ndryshme për servirje dhe gatim.	copë
25	Lugë shërbimi	Lugë profesionale për servirje ushqimi, inox, rezistente ndaj përdorimit intensiv.	copë
26	Pirun kuzhine	Pirun profesional inox për gatim dhe shërbim ushqimi.	copë

27	Kapëse kuzhine	Kapëse profesionale për sallatë, mish dhe pasta, inox rezistent.	copë
28	Rende djathi	Rende profesionale inox për djathë dhe perime, me dorezë të sigurt.	copë
29	Qërues perimesh	Qërues profesional perimesh, teh inox i mprehtë, trup ergonomik.	copë
30	Kulluese (Chinois)	Kulluese profesionale inox me rrjetë të imët, për filtrime ushqimesh dhe salcash.	copë
31	GN enë inox 1/1 (6.5 cm)	Enë GN inox 1/1, thellësi 6.5 cm, rezistente ndaj temperaturës dhe larjes industriale.	copë
32	Forma gatimi (set)	Set forma gatimi profesionale, materiale rezistente ndaj temperaturës së lartë.	set
33	Forma rrethore për prezantim	Forma profesionale për plating dhe prezantim ushqimi, inox.	copë
34	Mullinj kripe & piper	Set mullinj profesional për kripë dhe piper, mekanizëm rregullues i bluarjes.	set
35	Mbajtëse salcash 450 ml	Mbajtëse profesionale për salca, material qelqi/inox, me dozim të kontrolluar.	set
36	Mbajtëse ushqimi plastike 1.4 L	Kontejner ushqimi profesional, plastik ushqimor BPA-free, hermetik.	copë
37	Box ruajtje ushqimi	Kuti profesionale ruajtjeje ushqimi, hermetike, rezistente ndaj temperaturës.	copë
38	Blender dore profesional	Blender profesional inox, motor i fuqishëm, për përdorim intensiv në kuzhinë.	copë
39	Peshore elektronike 5 kg	Peshore profesionale digjitale, saktësi e lartë deri në 5 kg.	copë
40	Gota uji / pije	Gota profesionale qelqi për pije, rezistente ndaj goditjeve dhe larjes industriale.	copë
41	Gota vere të kuqe	Set gotash profesionale për verë të kuqe, qelq kristal ose ekuivalent.	set
42	Gota shampanje	Set gotash profesionale për shampanjë, dizajn elegant dhe rezistent.	set
43	Mbajtëse akulli + kapëse	Set profesional për akull me kapëse inox, për shërbim bari.	set
44	Tabaka bari	Tabaka profesionale shërbimi 30×40 cm dhe 20×30 cm, material anti-rrëshqitës.	copë
45	Menu restoranti / bari	Menu profesionale për restorant, material rezistent ndaj lagështirës dhe përdorimit intensiv.	copë
46	Mbajtëse letrash (bill holder) inox	Mbajtëse profesionale inox për fatura, dizajn rezistent dhe higjienik.	copë
47	Mbajtëse vaj/uthull (set)	Set profesional për vaj dhe uthull, qelq + inox, me dozim të kontrolluar.	copë

SPECIFIKIMET TEKNIKE LOTI 2 “BLERJE KABINET PËR INSTALIME HIDRAULIKE”

Nr.	Specifikimet e kërkuara	Specifikime teknike minimale	Njësia
❖ 1	Pompe uji elektrike teke e paisur me pulmon dhe presostat	Pompë uji elektrike monofazë 220–240V, e pajisur me presostat automatik dhe depo presioni (pulmon), trup inox ose gize, për përdorim shtëpiak dhe laboratorik, presion pune minimum 3–4 bar.	copë
❖ 2	Aparat ngjitje për material PPR 220V njëfazore	Aparat saldimit për tuba PPR, 220V monofazë, temperaturë e rregullueshme 0–300°C, me set kokash për diametra të ndryshëm, përdorim profesional.	copë
3	Balltdeze 25 mm me kabëll 3x1.5	Balltdeze/valvul 25 mm me kabëll elektrik 3x1.5 mm ² , izolim PVC, për përdorim në instalime hidraulike dhe elektrike të kombinuara.	copë
4	Trapan me shliza 2–24 GBH me goditje	Trapan profesional me goditje (hammer drill), fuqi minimum 800–1000W, kapacitet shpimi 2–24 mm, sistem SDS ose ekuivalent.	copë
5	Mandravida mekanike me ¼ me hapje	Mandravidë mekanike me kapje 1/4”, trup çeliku të forcuar, për përdorim hidraulik dhe mekanik profesional.	copë
6	Sharrë mekanike dore 2x400	Sharrë dore mekanike për prerje metali/druri, teh 400 mm, konstruktion çeliku, dorezë ergonomike anti-rrëshqitje.	copë
7	Seri çelësash 2x400 inox	Set çelësash inox, rezistent ndaj korrozionit, madhësi të ndryshme deri 400 mm, për përdorim profesional mekanik/hidraulik.	copë
❖ 8	Nivel magnetik metalik me lazer	Nivel profesional me trup alumini magnetik, i pajisur me sistem lazer për matje precize horizontale dhe vertikale.	copë
❖ 9	Nivel magnetik i zakonshëm me xham 600 mm	Nivel ndërtimi 600 mm, trup alumini, me 2–3 flluska matëse, bazë magnetike për fiksime në sipërfaqe metalike.	copë
❖ 10	Lavapjatë inox 90 cm me 1 gropë + 1 kollon	Lavapjatë inox 304, gjerësi 90 cm, me 1 gropë larëse dhe vend kullimi, rezistente ndaj korrozionit dhe temperaturës.	copë
11	Tavolinë pune hidraulike me bango druri dhe dollap 120x80x85	Tavolinë pune profesionale me konstruktion metalik, sipërfaqe druri të fortë, dollap për vegla, dimensione 120x80x85 cm.	copë
12	Tavolinë për lavapjatë druri 120x60x85	Tavolinë mbajtëse për lavapjatë, konstruktion druri i trajtuar kundër lagështisë, dimensione 120x60x85 cm.	copë
❖ 13	Kaçavida me veshje PVC komplet (kryq)	Set kaçavidash profesionale të izoluara PVC deri në 1000V, tip kryq (PH), për punime elektrike.	set
❖ 14	Kaçavida me veshje PVC komplet minus	Set kaçavidash të izoluara PVC deri në 1000V, tip i drejtë (-), për punime elektrike profesionale.	set

15	Dalte me veshje PVC 35 cm dhe 30 cm	Dalta profesionale me dorezë të izoluar PVC, gjatësi 30–35 cm, për punime mekanike dhe ndërtimore.	copë
16	Morse hidraulike me hapje deri në 4 inch	Mors hidraulik për fiksime tubash, hapje deri në 4", trup çeliku i forcuar, përdorim profesional.	copë
17	Çelës hidraulik me hapje nga 3/8 deri 1"	Çelës i rregullueshëm hidraulik, hapje 3/8" deri 1", çelik krom-vanadium, për punime profesionale.	copë
18	Çelës hidraulik me hapje nga 3/8 deri 2"	Çelës hidraulik i rregullueshëm, hapje 3/8" deri 2", trup i përforcuar për ngarkesa të larta.	copë
19	Çelës anglez me hap 3/8 deri 2	Çelës anglez i rregullueshëm, hapje 3/8" deri 2", material çelik i trajtuar kundër korrozionit.	copë
20	Çelës hidraulik nga 1 deri 2"	Çelës i rregullueshëm për tubacione, hapje 1" deri 2", për përdorim profesional hidraulik.	copë
21	Çekiç pune i vogël 1kg dhe i madh 2kg (2+2)	Çekiçe profesionale me dorezë ergonomike, 1kg dhe 2kg, trup çeliku i forcuar.	copë
❖ 22	Pincë e izoluar elektrike	Pincë profesionale e izoluar deri në 1000V, për punime elektrike, material çelik krom-vanadium.	copë
23	Talia tub për tuba 3/8 deri në 1"	Vegël për prerje/tërheqje tubash, e përshtatshme për diametra 3/8" deri 1", trup metalik.	copë
24	Kokë saldimi për gaz propan	Kokë saldimi profesionale për gaz propan, me flakë të rregullueshme, për punime hidraulike.	copë
❖ 25	Pres mekanike për hidraulikë për tuba multistrat 16–32 mm	Mjet presimi mekanik për tuba multistrat, diametra 16–32 mm, sistem manual profesional.	copë
❖ 26	Presë tubash elektrike për multistrat 16–32 mm	Makinë presimi elektrike për tuba multistrat, 16–32 mm, motor elektrik profesional me sistem sigurie.	copë
❖ 27	Pompë presimi rrjeti deri në 10 bar mekanike	Pompë testimi presioni manuale, deri në 10 bar, për testim rrjetesh hidraulike.	copë
❖ 28	Mandravidë elektrike deri në 2"	Mandravidë elektrike profesionale për filetim tubash deri në 2", motor elektrik industrial.	copë
29	Gur prerje dore	Disk prerës profesional për metal, rezistent ndaj konsumit, për makineri prerëse dore.	copë
❖ 30	Vidator me bateri 20V	Vidator profesional me bateri Li-Ion 20V, me karikues dhe 2 bateri, çift rrotullues i lartë.	copë
❖ 31	Aparat për zbulimin e rrjedhjeve në instalime pa hapur murin	Pajisje elektronike për detektim rrjedhjesh uji në mure/tuba, sensor akustik dhe elektronik, përdorim profesional.	copë
❖ 32	Aparat ngjitës monofazë (elektrofuzion) për tuba polietileni deri në 4"	Makinë elektrofuzioni për tuba PE, 220V, për diametra deri në 4", me kontroll automatik temperature dhe kohe.	copë
33	Kabinë mësimore hidraulike / ishull modular	Strukturë mësimore hidraulike me 6 module të çmontueshme, konstrukcion çeliku, sipërfaqe metalike të veshur me llamarinë, për montim pajisjesh hidrosanitare dhe tubacione, dimension 80x180x6 cm për njësi.	copë
Nr.	PAISJET E KABINETIT	Specifikime teknike minimale	Njësia
❖ 1	Dush horizontal 80 L	Ngrohës uji elektrik horizontal, kapacitet 80 L, rezervuar inox ose i veshur kundër korrozionit,	copë

		termostat i rregullueshëm dhe mbrojtje ndaj mbinxehjes.	
❖ 2	Dush 10 L për kuzhinë	Ngrohës uji elektrik 10 L për kuzhinë, montim mural, 220–240V, me izolim termik dhe kontroll temperature.	copë
❖ 3	Dush elektronik 50 L	Ngrohës uji elektrik 50 L, kontroll elektronik temperature, ekran digjital, mbrojtje IPX4, 220–240V.	copë
4	Lavaman me kollonë porcelan i bardhë	Lavaman porcelani i bardhë me kollonë, rezistent ndaj gërvishtjeve dhe njollave, montim mural ose me bazë.	copë
5	WC allafranga	WC porcelani (floor standing), sistem shkarkimi efikas, material antibakterial dhe rezistent.	copë
❖ 6	Kasetë WC inkaso komplet	Sistem WC inkaso i kompletuar me rezervuar të fshehur, mekanizëm shkarkimi dual flush dhe strukturë metalike mbajtëse.	copë
7	Bidé porcelani e bardhë e varur	Bidé e varur porcelani, montim mural, me dalje standarde uji dhe material antibakterial.	copë
8	Stafa bidjeje	Set stafe metalike për montim bidéje, çelik inox rezistent ndaj korrozionit.	copë
9	Pllakë dushi plastike harkore 80x80	Pllakë dushi akrilike/ABS 80x80 cm, formë harkore, sipërfaqe anti-rrëshqitje.	copë
❖ 10	Kabinë dushi 80x80	Kabinë dushi 80x80 cm, xham i temperuar, profil alumini anti-korrozion, hapje rrëshqitëse ose me hapje.	copë
❖ 11	Ngrohës elektro-hidraulik për banjë	Ngrohës uji elektrik për banjë, sistem hidro-elektrik, mbrojtje ndaj presionit dhe temperaturës së lartë.	copë
❖ 12	Lavapjatë inox me gropë + kullim (1+1)	Lavapjatë inox 304, 1 gropë + 1 hapësirë kullimi, rezistente ndaj korrozionit dhe temperaturës.	copë
13	Tavolinë druri për lavapjatë 120x60x85	Tavolinë mbajtëse lavapjate, konstrukcion druri i trajtuar kundër lagështisë, dimension 120x60x85 cm.	copë
14	Kasetë kolektori 45x45	Kasetë metalike për kolektor hidraulik, dimension 45x45 cm, montim mural, me derë aksesimi.	copë
15	Kolektor ¾ me katër dalje	Kolektor bronzi ¾” me 4 dalje, i pajisur me valvola individuale mbyllëse.	copë
16	Kolektor ¾ me tre dalje	Kolektor bronzi ¾” me 3 dalje, me rregullim dhe mbyllje individuale për çdo dalje.	copë
17	Kolektor ¾ me dy dalje	Kolektor bronzi ¾” me 2 dalje, për shpërndarje uji në linja të veçanta.	copë
18	Buketona kolektori	Kapëse/mbajtëse për fiksime kolektorësh në mur ose kasetë, material metalik rezistent.	copë
❖ 19	Grup dushi inkaso deviator	Grup dushi inkaso me deviator, kontroll për kalim ujë dush/kran, material krom inox.	copë
20	Grup lavamani	Set rubineti lavamani, njëdorësh, trup bronzi i kromuar, fishek qeramik.	copë

❖ 21	Grup bidéje	Rubinet bidéje, njëdorësh, material bronzi kromuar, me aerator kursimi uji.	copë
22	Pilete dysHEMEJE	Piletë dysHEMEJE inox/PVC, me filtër kundër erërave dhe mbetjeve, diametër standard.	copë
23	Pilete lineare 50 cm	Piletë lineare dushi 50 cm, inox, me grilë dekorative dhe sistem kullimi të shpejtë.	copë
24	Sifon lavamani unik	Sifon lavamani PVC/ABS, sistem kundër erërave, i çmontueshëm për pastrim.	copë
25	Sifon bidéje	Sifon për bidé, material PVC rezistent, montim standard.	copë
26	Sifon lavapjate	Sifon për lavapjatë inox, me sistem anti-blokim dhe pastrim të lehtë.	copë
27	Rregullator presioni $\frac{3}{4}$	Rregullator presioni uji $\frac{3}{4}$ ", trup bronzi, presion i rregullueshëm dhe stabilizim automatik.	copë
❖ 28	Manometër presioni	Manometër uji 0–10 bar, dial analog ose digjital, për matje presioni në rrjet.	copë
29	Filter rrjeti $\frac{3}{4}$	Filter uji $\frac{3}{4}$ ", trup bronzi ose plastik i përforcuar, me element filtri të pastrueshëm.	copë
❖ 30	Sahat uji $\frac{3}{4}$	Matës uji $\frac{3}{4}$ ", mekanik, i certifikuar për matje konsumimi uji, saktësi e lartë.	copë
31	Saracineske $\frac{3}{4}$	Valvul mbyllëse $\frac{3}{4}$ ", bronz ose inox, me levë manuale dhe presion të lartë pune.	copë
❖ 32	Valvol moskthimi	Valvul njëdrejtimëshe (non-return valve), për parandalim kthimi uji, material bronzi/PVC.	copë
33	Tubo multistrat 16x2 mm	Tub multistrat PEX-AL-PEX 16x2 mm, rezistent ndaj presionit dhe temperaturës së lartë.	metër
34	Brryla 16x1/2 F	Brryl lidhës 16x1/2" femër, për tuba multistrat, material bronzi i nikluar.	copë
35	Brryla 16x1/2 M	Brryl lidhës 16x1/2" mashkull, bronz i nikluar, për instalime hidraulike.	copë
36	Rekorderi 16x1/2 M	Rekorder lidhës 16x1/2" mashkull, bronz i forcuar, për tuba multistrat.	copë
37	Saraçineske $\frac{3}{4}$	Valvul mbyllëse $\frac{3}{4}$ ", trup bronzi, levë metalike, presion pune standard.	copë
38	Tuba PPR Ø20	Tub PPR Ø20 mm, për ujë të ftohtë dhe të ngrohtë, rezistent ndaj presionit dhe temperaturës.	metër
39	Tuba të thjeshta	Tub PVC standard për instalime të thjeshta, rezistent ndaj presionit të ulët.	metër
40	Tub 20x1/2 F	Tub lidhës 20x1/2" femër, për instalime hidraulike PPR, i saldueshëm.	metër
41	Brryla 20x1/2 F	Brryl PPR 20x1/2" femër, për lidhje instalimesh hidraulike.	copë
42	Brryla 20x1/2 M	Brryl PPR 20x1/2" mashkull, për sistemet e ujit.	copë
43	Xhunto 20x1/2 M	Xhunto lidhëse 20x1/2" mashkull, për bashkim tubash PPR.	copë
44	Kalesa 20	Kapëse tubi Ø20 mm, për fiksime në mur ose strukturë.	copë
45	Manikot 20	Manikot lidhës Ø20 mm, për bashkim tubash PPR.	copë

46	Saraçinesk 20	Valvul mbyllëse Ø20 mm, për instalime PPR, trup bronzi ose plastik i përforcuar.	copë
----	---------------	--	------

SPECIFIKIMET TEKNIKE : LOTI 3 “BLERJE KABINET PËR MIRËMBAJTJE RRJETI ELEKTRIK”

Nr.	Specifikimet e kërkuara	Specifikime teknike minimale	Njësia
❖ 1	Kontaktor F+N, modular, bobinë 220V, 2 polar	Kontaktor modular për montim në shinë DIN, 2 pole (F+N), bobinë 220–240V AC, 50Hz, rrymë nominale minimum 20A, standard IEC/EN.	copë
❖ 2	Kontaktor 3F+N, bobinë 220V	Kontaktor modular 4-polësh (3F+N), bobinë 220–240V AC, montim në shinë DIN, rrymë nominale minimum 20A.	copë
❖ 3	Kontaktor 3F, bobinë 220V	Kontaktor trefazor 3-polësh, bobinë 220–240V AC, rrymë nominale minimum 25A, montim në shinë DIN.	copë
4	Rele ndriçimi shkalle	Rele elektronike për komandimin e ndriçimit të shkallëve, tension pune 230V AC, kohë e rregullueshme, montim në shinë DIN.	copë
5	Rele korpuskulare (sensor drite/muzgu)	Sensor drite me prag aktivizimi të rregullueshëm, tension pune 230V AC, shkallë mbrojtjeje minimum IP54.	copë
❖ 6	Rele kalimi personi	Sensor lëvizjeje PIR, tension pune 230V AC, kohë dhe ndjeshmëri të rregullueshme, distancë detektimi minimum 6 m.	copë
❖ 7	Rele mbrojtje luhatje tensioni njëfazore	Pajisje për mbrojtje ndaj mbi-tensionit dhe nën-tensionit, 230V AC, me rilidhje automatike dhe parametra të rregullueshëm.	copë
❖ 8	Rele mbrojtje luhatje tensioni trefazore	Rele monitorimi për rrjete trefazore 400V AC, me mbrojtje ndaj mbi-tensionit, nën-tensionit dhe humbjes së fazës.	copë
❖ 9	Rele mbrojtje renditje faze trefazore	Rele për kontrollin e renditjes së fazave dhe mungesës së fazës në rrjete trefazore 400V AC, me sinjalizim LED.	copë
10	Audio citofoni (2 tela) komplet	Sistem audio citofonie me 2 tela, i kompletuar me panel të jashtëm, aparat të brendshëm dhe furnizues energjie.	set
❖ 11	Video citofoni (2 tela) komplet	Sistem video citofonie me monitor minimum 7”, panel të jashtëm me kamerë, furnizues energjie dhe funksion hapjeje dere.	set

❖ 12	Matës tokëzimi (Terrameter)	Instrument profesional për matjen e rezistencës së tokëzimit, ekran dixhital, komplet me sonda dhe kablllo matëse.	copë
❖ 13	Matës izolacioni (për motorë/instalime)	Megger dixhital me tensione prove 250V, 500V dhe 1000V, matje deri minimum 1000 MΩ, CAT III.	copë
14	Tambur zgjatues 20–30 m	Tambur kabllor me gjatësi 20–30 m, kablllo bakri me tokëzim, minimum 4 priza Shuko, mbrojtje termike.	copë
15	Trapan elektrik (shpim + goditje)	Trapan profesional me funksion shpimi dhe goditjeje, fuqi minimum 800W, mandrinë 13 mm.	copë
16	Vidator me bateri	Vidator profesional me bateri Li-Ion minimum 12V, me karikues dhe minimum 2 bateri.	copë
❖ 17	Komplet kaçavida profesionale elektrici	Set kaçavidash profesionale të izoluara deri në 1000V, me certifikim VDE ose ekuivalent.	set
18	Indikator tensioni 250–500V	Pajisje për kontrollin e pranisë së tensionit AC, me izolim sipas standardeve të sigurisë elektrike.	copë
❖ 19	Indikator tensioni akustik (detektor) 250–500V	Detektor tensioni pa kontakt me sinjalizim akustik dhe vizual, diapazon pune minimum 90–1000V AC.	copë
❖ 20	Poste pune kursanti 1F+3F (8 copë)	Poste laboratorike për trajnim profesional në instalime elektrike, të kompletuara me elementë komandimi, mbrojtjeje, sinjalizimi dhe matjeje sipas skemave didaktike.	copë
21	Banko për çdo post pune me përmasa (200x60x90 cm)	Banko pune me konstruksion metalik të lyer elektrostatisht, sipërfaqe rezistente ndaj goditjeve dhe lagështisë, përmasa 200x60x90 cm.	copë
Nr.	Specifikimet e kërkuara	Specifikime teknike minimale	Njësia
❖ 1	Kuti automatike 12 module	Kuti shpërndarëse elektrike 12 module, material vetëshuarës, IP40 ose më i lartë, e kompletuar me shinë DIN dhe kapak mbrojtës.	copë
❖ 2	Automat 10A, 1P	Ndërprerës automatik termomagnetik 1P, 10A, 230/400V AC, karakteristikë C, kapacitet ndërprerës min. 6kA.	copë
❖ 3	Automat 16A, 1P	Ndërprerës automatik termomagnetik 1P, 16A, 230/400V AC, karakteristikë C, kapacitet ndërprerës min. 6kA.	copë
❖ 4	Automat 20A, 1P	Ndërprerës automatik termomagnetik 1P, 20A, 230/400V AC, karakteristikë C, kapacitet ndërprerës min. 6kA.	copë
5	Llambë sinjali 1F	Llambë sinjalizuese modulare 230V AC, për montim në panel elektrik, me jetëgjatësi të lartë.	copë

❖ 6	Mbrojtje diferenciale 40A	Diferencial 40A, 30mA, 2P, tension pune 230V AC, tip AC ose A, standard IEC/EN 61008.	copë
7	Skemë lidhje komandimi dritë me 1 pikë	Set didaktik i kompletuar për realizimin e komandimit të ndriçimit nga një pikë, me kabllim dhe aksesore instalimi.	copë
8	Skemë lidhje komandimi dritë me 3 pika	Set didaktik i kompletuar për realizimin e komandimit të ndriçimit nga tre pika, me çelësa deviatë dhe inverter.	copë
9	Portollampë braçet + llampë	Portollampë me llampë LED 230V AC, i përshtatshëm për përdorim laboratorik dhe demonstrime praktike.	copë
10	Çelës i thjeshtë	Çelës njëpolar 10A, 250V AC, për instalime elektrike të brendshme.	copë
11	Çelës deviat	Çelës deviat 10A, 250V AC, për komandim ndriçimi nga dy pika.	copë
12	Çelës inverter	Çelës inverter 10A, 250V AC, për komandim ndriçimi nga tre ose më shumë pika.	copë
13	Kuti çelësi 1M	Kuti instalimi për 1 modul, material vetëshuarës, e përshtatshme për montim të çelësave dhe prizave.	copë
Nr.	Specifikimet e kërkuara	Specifikime teknike minimale	Njësia
❖ 1	Shinë automatike 6 module	Kuti/shinë shpërndarëse elektrike me kapacitet minimum 6 module, material vetëshuarës, e kompletuar me shinë DIN dhe aksesoret e montimit.	copë
❖ 2	Automat 10A, 1P	Ndërprerës automatik termomagnetik 1P, 10A, 230/400V AC, karakteristikë C, kapacitet ndërprerës minimum 6kA.	copë
❖ 3	Automat 16A, 1P	Ndërprerës automatik termomagnetik 1P, 16A, 230/400V AC, karakteristikë C, kapacitet ndërprerës minimum 6kA.	copë
❖ 4	Skemë lidhje prizë Shuko 16A	Set didaktik i kompletuar për realizimin e lidhjes së një prize Shuko 16A, me kabllim, aksesore dhe elementë montimi për demonstrim praktik.	copë
❖ 5	Skemë lidhje prizë Shuko 16A me prizë bivalente 16A	Set didaktik për realizimin e lidhjes së prizës Shuko 16A dhe prizës bivalente 16A, me të gjithë komponentët dhe kabllimin e nevojshëm.	copë
❖ 6	Skemë lidhje prizë Shuko 16A me komandim drite 1 pikë	Set didaktik për realizimin e qarkut me prizë Shuko 16A dhe komandim ndriçimi nga një pikë, me komponentët dhe kabllimin përkatës.	copë
❖ 7	Skemë lidhje prizë Shuko 16A me komandim drite 3 pika	Set didaktik për realizimin e qarkut me prizë Shuko 16A dhe komandim ndriçimi nga tre pika, me çelësa deviatë, inverter dhe kabllim instalimi.	copë
8	Kuti jashtë muri 3M	Kuti instalimi për montim sipërfaqësor, kapacitet 3 module, material	copë

		vetëshuarës, rezistente ndaj goditjeve mekanike.	
9	Çelës i thjeshtë	Çelës njëpolar për instalime elektrike, tension nominal 250V AC, rrymë nominale minimum 10A.	copë
10	Çelës deviat	Çelës devijues për komandim ndriçimi nga dy pika, tension nominal 250V AC, rrymë nominale minimum 10A.	copë
11	Çelës inverter	Çelës ndërmjetës (inverter) për komandim ndriçimi nga tre ose më shumë pika, tension nominal 250V AC, rrymë nominale minimum 10A.	copë
12	Prizë Shuko	Prizë Shuko 16A me kontakt tokëzimi, tension nominal 250V AC, material termoplastik rezistent ndaj temperaturës dhe goditjeve.	copë
13	Prizë bivalente 16A	Prizë bivalente 16A, tension nominal 250V AC, e përshtatshme për përdorim në instalime të brendshme, material vetëshuarës.	copë
Nr.	Specifikimet e kërkuara	Specifikime teknike minimale	Njësia
❖ 1	Shinë automatike 6 module	Kuti/shinë shpërndarëse elektrike me kapacitet minimum 6 module, material vetëshuarës, e kompletuar me shinë DIN dhe aksesore montimi.	copë
❖ 2	Automat 10A, 1P	Ndërprerës automatik termomagnetik 1P, 10A, 230/400V AC, karakteristikë C, kapacitet ndërprerës minimum 6kA.	copë
3	Llambë sinjali 1F	Llambë sinjalizuese modulare 230V AC për montim në panel elektrik, me jetëgjatësi të lartë dhe tregues vizual.	copë
4	Rele ndriçimi shkalle	Rele elektronike për komandimin e ndriçimit të shkallëve, tension pune 230V AC, kohë e rregullueshme, montim në shinë DIN.	copë
5	Rele taimer (kohë)	Rele kohore (timer) për komandim automatik të qarqeve elektrike, me interval kohe të rregullueshëm, montim në shinë DIN, 230V AC.	copë
❖ 6	Rele kalimi personi	Sensor lëvizjeje PIR për detektim pranije, tension pune 230V AC, kohë dhe ndjeshmëri të rregullueshme, distancë detektimi minimum 6 m.	copë
❖ 7	Rele korpuskulare (muzgu)	Sensor drite (dusk/dawn switch), tension pune 230V AC, prag ndriçimi i rregullueshëm, shkallë mbrojtjeje minimum IP54.	copë
8	Çelës pulsant	Çelës pulsant për komandim releje shkalle, tension nominal 250V AC, rrymë nominale minimum 10A.	copë

9	Çelës 0/I	Çelës komandimi ON/OFF (0/I), tension nominal 250V AC, rrymë nominale minimum 10A.	copë
10	Kuti jashtë muri 1M	Kuti instalimi sipërfaqësor për 1 modul, material vetëshuarës, rezistente ndaj goditjeve mekanike.	copë
11	Kontaktor modular 2 polar, 220V/50Hz	Kontaktor modular 2P (F+N), bobinë 220–240V AC, montim në shinë DIN, rrymë nominale minimum 20A, standard IEC/EN.	copë
Nr.	Specifikimet e kërkuara	Specifikime teknike minimale	Njësia
1	Shinë automate 6 module	Kuti/shinë shpërndarëse elektrike me kapacitet minimum 6 module, material vetëshuarës, e kompletuar me shinë DIN dhe aksesore montimi.	copë
❖ 2	Automat 10A, 2P	Ndërprerës automatik termomagnetik 2P, 10A, 230/400V AC, karakteristikë C, kapacitet ndërprerës minimum 6kA.	copë
3	Llambë sinjali 1F	Llambë sinjalizuese modulare 230V AC për montim në panel elektrik, me tregues vizual dhe jetëgjatësi të lartë.	copë
4	Skemë lidhje zile elektrike	Set didaktik për realizimin e komandimit të ziles elektrike, me të gjithë komponentët, kabllimin dhe aksesoret për demonstrim praktik.	copë
5	Zile alarmi akustik (këmbanë)	Zile alarmi akustik 230V AC, me intensitet të lartë zëri, e përshtatshme për sinjalizim industrial ose laboratorik.	copë
6	Amplifikator sinjali TV (220V)	Amplifikator sinjali TV për rrjet 220–240V AC, përforcim i sinjalit me humbje minimale, montim i brendshëm.	copë
7	Shpërndarës TV 1-2	Splitter sinjali TV 1 hyrje – 2 dalje, me humbje të ulët sinjali, për instalime koaksiale standarde.	copë
8	Shpërndarës TV 1-4	Splitter sinjali TV 1 hyrje – 4 dalje, me balancim të sinjalit dhe humbje minimale.	copë
9	Shpërndarës TV përmyllës 1-2	Terminator/splitter për përfundim linje TV 1-2, për stabilizim sinjali dhe reduktim interferencash.	copë
